

Bordi i Drejtorëve të KRU "Mitrovica" Sh.A bazuar në nenin 34 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-111 dhe Ligji Nr.05/L-009, nenit 4 të Ligjit të Punës në Kosovë Nr.03/L-212, si dhe bazuar në nenin 7 në Statutin e Ndërmarrjes Publike Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica" Sh.A në mbledhjen e mbajtur me datë 25.11.2024 aporvoi këtë:

RREGULLORE NR. 15/24 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES NR.1347/2 MBI SISTEMATIZIMIN E VENDEVE TË PUNËS DHE ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË PUNËVE DHE DETYRAVE TË PUNËS TË KOMPANISË RAJONALE UJËSJELLËSI "MITROVICA" SH.A. NË MITROVICË

Neni 1

Qëllimi i kësaj Rregullore është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullore nr.1347/2 mbi sistematizimin e vendeve të punës dhe organizimin e brendshëm të punëve dhe detyrave të punës te KRU,, Mitrovica,, Sh. A

Neni 2

Plotësim ndryshimi në pozitën e Laborant te përshkrimi i detyrave të punës bëhet plotësim ndryshimi ku në vend të pikës për punën që kryen i përgjigjet Inxhinierit të Procesit apo Menaxherit të Përpunimit të Ujit plotësohet dhe ndryshohet me pikën për punën që kryen i përgjigjet Shefit të Cilësisë së Ujit dhe Burimeve.

Tek përgatitja profesionale shtohet edhe Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore- Fakulteti i Kimisë si dhe Shkolla e Mesme –Drejtimi i Kimisë do të jenë të preferueshme.

Neni 3

Plotësim ndryshimi në pozitën e Shef i Mekanizimit, te përshkrimi i detyrave të punës bëhet plotësim ndryshimi ku në vend të pikës për punën që kryen i përgjigjet Menaxherit Operativ plotësohet dhe ndryshohet me pikën për punën që kryen i përgjigjet Drejtorit Teknik.

Neni 4

Plotësim ndryshimi në pozitën Lexues i Ujëmatësve tek kushti i veçantë- trajnimet të jetë përparësi për këtë pozitë.

Neni 5

Me këtë Rregullore bëhet ndryshim plotësimi i rregullores përkatëse, për tu harmonizuar me plotësimet e përdorura në këtë Rregullore.

Neni 6

Kjo Rregullore hynë në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Kryesuesja e Bordit të Drejtorëve të KRU,, Mitrovica,, Sh.A.- Mitrovicë si dhe publikimit të saj në ueb-faqen e Kompanisë.

Kumrije Kelmendi Ahu - Kryesuese e Bordit të Drejtorëve

